



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	03-02/1016/17
Data Datum Date	12.04.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.04.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-3357/16, për znj. Luljeta Sokoli – Këshilltare Politike në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për shkak se zyrtarja e lartë ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-3357/16, për znj. Luljeta Sokoli – Këshilltare Politike në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtarja e lartë znj. Sokoli, është hetuar për konflikt të mundshëm interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë pronare aktive në biznesin privat “Ark - L”.

Agjencia kundër Korrupsionit ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit ku fillimisht ka njoftuar zyrtaren e lartë me shkresë zyrtare. Më pas, znj. Sokoli është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t’i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Ajo është bindur për kufizimet në ushtrimin e të drejtës aktive të pronësisë në biznesin privat, krahas ushtrimit të funksionit publik dhe ka premtuar që në afat sa më të shpejt do të shmang konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.



Ndërkohë znj. Sokoli ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilat vërtetohet se vullnetarisht ka mbyllur biznesin privat “Ark - L”. Me këtë ajo ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Shaip Havolli

